



# Qualified Health Plan Në një vështrim të shpejtë

## KUSH KUALIFIKOHET?

### INDIVIDË QË:

- Janë banorë të New York State
- Janë rezidentë të ligjshëm në SHBA
- Nuk kualifikohen për "Medicaid", Essential Plan ose "Child Health Plus"

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, kombësisë, besimit/fesë, gjinisë, moshës, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

## ÇFARË MBULOHET?

- Kujdes parandalues falas
- Kujdes për pacientë të brendshëm
- Shërbime ambulatorë
- Kujdes neonatal dhe për nënën
- Shërbime emergjence
- Laborator dhe imazheri
- Barna me recetë
- Shërbime rehabilitimi dhe trajtimi
- Shërbime për persona me çrregullime të shëndetit mendor ose të përdorimit të substancave
- Shërbime trajtimi dhe menaxhimi të sëmundjeve kronike
- Kujdes dentar dhe okulistik për fëmijët

***Kujdesi dentar për të rriturit dhe përfitime të tjera mund të mbulohen gjithashtu nga plane të caktuara.***

### NA KONTAKTONI:

[nystateofhealth.ny.gov](http://nystateofhealth.ny.gov) | 1-855-355-5777 ose TTY 1-800-662-1220

# SA KUSHTON QUALIFIED HEALTH PLAN (QHP)?

**PRIMET MUJORE:** Çmimi që paguani çdo muaj do të jetë në varësi të planit që zgjidhni. Pjesa më e madhe e njerëz kualifikohen për kreditime tatimi që ulin koston mujore. Kreditimet e tatimit llogariten duke u bazuar te të ardhurat tuaja, numri i pjesëtarëve të familjes dhe vendbanimi juaj.

**NDARJA E KOSTOVE:** Ndarja e kostove është shuma që paguani kur merrni një shërbim kujdesi shëndetësor. Disa njerëz kualifikohen gjithashtu për marrjen e ndihmës për shlyerjen e këtyre kostove, në bazë të të ardhurave të tyre. Më poshtë paraqiten shembuj të nivelit të ndarjes së kostove të QHP-së për planet standarde të ofruara në katër nivele. Planet e tjera ofrohen me ndarje të ndryshme kostosh dhe me shërbime shtesë të mbuluara.

NDARJA E KOSTOVE PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR	PLATIN	AR	ARGJEND	BRONZ
Tarifat e zbritshme vjetore	\$0	\$600	\$1,750	\$4700
Kujdesi parandalues	Falas	Falas	Falas	Falas
Vizitë te mjeku i kujdesit parësor*	\$15	\$25	\$30	\$50
Vizitë te specialisti*	\$35	\$40	\$65	\$75
Shtrim në spital për pacientë të brendshëm	\$500	\$1,000	\$1,500	\$1,500
Vizitë shëndetësore e sjelljes për pacientë të jashtëm	\$15	\$25	\$30	\$50
Vizitë shëndetësore e sjelljes për pacientë të brendshëm për shtrim	\$500	\$1,000	\$1,500	\$1,500
Sallë emergjence	\$100	\$150	\$500	\$500
Kujdes urgjent	\$55	\$60	\$70	\$75
Terapi fizike, terapi ligjërimi, terapi okupacionale	\$25	\$30	\$30	\$50

\*Të gjitha planet "Standard Bronze" të 2023 mundësojnë gjithsej tre vizita tek ofruesit e kujdesit parësor shëndetësor ose specialistët para se të arrihet tarifa e zbritshme (kërkohej që klienti të paguajë bashkëpagesën). Të gjitha planet "Standard Silver" të 2023 mundësojnë një vizitë tek ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor ose specialistët para se të arrihet tarifa e zbritshme (kërkohej që klienti të paguajë bashkëpagesën).

NDARJA E KOSTOVE PËR BARNAT ME RECETË	PLATIN	AR	ARGJEND	BRONZ
Të përgjithshme	\$10	\$10	\$15	\$10
Markë e preferuar	\$30	\$35	\$40	\$35
Markë jo e preferuar	\$60	\$70	\$75	\$70